

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Konkurrencës
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi - ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Valbon Mulaj
Detajet kontaktuese:	valbon.mulaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Në kuadër të plan-programit akademik për lëndët, kurset mësimore të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, për lëndë zgjedhore në semestrin e gjashtë (semestrin veror), është caktuar: E Drejta e Konkurrencës, me fond javor të orëve mësimore (dy orë ligjëratë) me gjithsej katër kredi. E Drejta e Konkurrencës, si disiplinë e përgjithshme shkencore hyrëse, teorike dhe praktike, ka për synim ofrimin e njohurive bazike për të drejtën e konkurrencës. Mbrojtja e konkurrencës është një prej parakushteve kryesore për funksionimin e ekonomisë së tregut duke zbatuar Kushtetutën, Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe aktet tjera nënligjore, duke siguruar kështu atë që tregu ofron - më të mirën për pjesëmarrësit e tregut.</p> <p>Lënda ka për qëllim që studentët, pas përfundimit të kësaj lënde, të jenë në gjendje ta zbatojnë në praktikë të drejtën e konkurrencës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kjo lëndë ka për qëllim që të aftësojë studentët e studimeve bachelor me pjesën teorike dhe praktike të të drejtës së konkurrencës. Studentët do të njihen me mënyrën e funksionimit të institucioneve vendore të të drejtës së konkurrencës, me mbrojtjen e konkurrencës sipas ligjeve vendore, si dhe me mënyrën dhe procedurën e harmonizimit të ligjeve vendore me ato të BE-së. Po ashtu, do të kuptojnë mbrojtjen nga konkurrenca jolojale.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj Lënde, studentët duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- t'i marrin njohuritë bazë për të Drejtën e Konkurrencës;

	<ul style="list-style-type: none"> - t'i shpjegojnë dhe analizojnë konceptet dhe parimet themelore dhe burimet e të drejtës së konkurrencës; - të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e konkurrencës në tregun vendor; - t'i kuptojnë ligjet vendore dhe harmonizimin e tyre me vendet e BE-së; - të analizojnë dhe të kuptojnë mënyrën e funksionimit të institucioneve shtetërore për mbrojtjen e konkurrencës; - të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike në shqyrtimin e rasteve praktike; - të mbrojnë konkurrencën nga aktet jolojale.
--	---

Kontributi më ngarkesën diturore të studentit (që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënimit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/5	5
Punë praktike	1	1/9	9
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në terren	1	1/3	3
Kollokfiume, seminare	1	1/7	7
Detyra të shtëpisë	1	1/5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/8	8
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/7	7
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	4	1/1	4
Projektet, prezantimet, etj	7	1/1	7
Totali	4 ECTS	Total	100

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Prezantimi i temës në ligjërata bëhet në mënyrë verbale, përmes Power Point-it, diskutime interaktive, ndarjeve në grupe dhe zgjidhje të rasteve praktike.</p> <p>Në çdo fillim ore do të ketë: përsëritje nga tema e kaluar për të filluar temën tjetër; prezantime të hulumtimeve individuale dhe grupore; analiza për lëndën.</p>
-------------------------------------	---

<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Për vlerësimin e studentëve, mësimdhënësi do të ketë në konsideratë këto kritere.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi i vazhdueshëm:</u></p> <p>Pikët në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi individual.....5 pikë; - Prezantimi dhe puna grupore.... ..5 pikë; - Punimi seminarik.....10 pikë; - Testi i parë 40 pikë; - Testi i dytë 40 pikë. <p>Studentët që arrijnë rezultat pozitiv përmes vlerësimit të vazhdueshëm, lirohen nga provimi.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi në provimin final:</u></p> <p>Studentët që nuk arrijnë sukses përmes vlerësimit të vazhdueshëm, hyjnë në provimin final. Provimi final ka gjithsej 80 pikë, kurse 20 pikët e cekura më lartë arrihen nga: Prezantimi individual - 5 pikë; Prezantimi dhe puna grupore - 5 pikë; Punimi seminarik - 10 pikë. Të gjitha këto pikë numërohen dhe transferohen në provimin final.</p>
Literatura	
<p>Literatura bazë:</p>	<p>Mehdi J. Hetemi: “Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurrenca jolojale (aspekti krahasimor)”, Prishtinë, 2007.</p> <p>Egzone Osmanaj & Adnan Jashari: “E drejta e konkurrencës (Në BE, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut)”, Prishtinë, 2021.</p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Fjoralba Caka: “Nocioni i Ndihmës shtetërore që çrregullon tregun e lirë dhe konkurrencën sipas legjislacionit dhe praktikës ndërkombëtare”, Tiranë, 2019. Disertacion për Mbrojtjen e Gradës Shkencore “Doktor” në Universitetin Shtetëror të Tiranës.</p> <p>Moritz Lorenz: “An Introduction to EU Competition Law”, Cambridge, Date Published: April 2013.</p> <p>Iva Zajmi “E drejta Europiane e konkurrencës (European Competition Law)”. Tirana, 2012.</p> <p>Richard Whish & David Bailey “Competition Law” Seventh Edition. Oxford University Press 2012.</p> <p>Mulaj, Valbon, “Protection of Competition from Abuse with Dominant Positions and Anticompetitive Agreements in the Kosovo</p>

	<p>Market”, <i>Studia Iuridica Lublinensia</i> 31, no. 2 (2022): 207-227.</p> <p>Mulaj, Valbon, “Improvement of the Kosovo market through implementation of the competition legal framework”, <i>The Lawyer Quarterly</i> 10, no. 3 (2020): 346–356.</p> <p>Materiale të përgatitura ose të përmbledhura nga profesori i lëndës, dhe të dorëzuara më kohë, që lejon hapësirë të mjaftueshme për studim përpara ligjëratisë përkatëse.</p> <p>Raste të përgatitura nga Profesori.</p> <p><i>Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës:</i> <i>Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.</i> <i>Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit.</i> <i>Ligji për Shoqëritë Tregtare.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<p>Prezantimi i lëndës, i literaturës, si dhe i rregullave të përgjithshme</p> <p>Vështrime të përgjithshme mbi lëndën: E Drejta e Konkurrencës</p>
<i>Java e dytë:</i>	<p>Njohuri të përgjithshme për lëndën E Drejta e Konkurrencës</p> <p>Aspekti juridik dhe ekonomik i rregullimit të konkurrencës; Burimet dhe parimet e të drejtës së konkurrencës; Pse është i dobishëm dhe i domosdoshëm ekzistimi i konkurrencës në treg; Rregullimi ligjor i konkurrencës; Shpjegim i shkurtër i monopolit, si ekstremi tjetër i konkurrencës.</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p>Ndalimi i marrëveshjeve kundërkonkurruese</p> <p>Llojet e marrëveshjeve kundërkonkurruese dhe natyra e tyre; Ndikimi i marrëveshjeve kundërkonkurruese në ekonomi dhe në rritjen e çmimeve.</p>
<i>Java e katërt:</i>	<p>Përcaktimi i pozitës dominuese dhe ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese</p> <p>Çfarë kuptimi ka pozita dominuese në treg; Sa për qind të tregut duhet të ketë në kontroll një kompani që të konsiderohet se ka pozitë dominuese; Trajtimi ndryshe i kompanive të cilat kanë pozitë dominuese dhe i atyre të cilat kanë pozitë të zakonshme në treg; Cila është rregullativa ligjore për kompanitë të cilat ndodhen në pozitë dominuese;</p>

	Si të ndalohet keqpërdorimi i pozitës dominuese.
<i>Java e pestë:</i>	<p>Përqendrimet Përqendrimi; Përqendrimet e ndaluara; Detyrimi për të kërkuar lejimin e përqendrimit; Përqendrimi i institucioneve financiare; Parashtrimi i kërkesës për lejimin e përqendrimit; Përmbajtja e kërkesës për lejimin e përqendrimit; Procedura e vlerësimit të përqendrimit; Vërtetimi dhe vendimi për lejimin e përqendrimit; Shfuqizimi dhe ndryshimi i vendimit për lejimin e përqendrimit; Masat pas realizimit të paligjshëm të përqendrimit.</p>
<i>Java e gjashtë:</i>	<p>Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës Themelimi, funksionimi dhe organizimi; Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës; Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit; Shkarkimi i anëtarit të Komisionit; Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit; Mënyra e vendimmarrjes; Sekretariati; Përgjegjësitë e Sekretariatit; Drejtori/a i/e Përgjithshëm/me; Parandalimi i konfliktit të interesit.</p>
<i>Java e shtatë:</i>	Testi I
<i>Java e tetë:</i>	<p>Zhvillimi i procedurës nga autoriteti për mbrojtjen e konkurrencës i Kosovës Mbrojtja e konkurrencës në raport me marrëveshjet kundërkonkurruese; Mbrojtja e konkurrencës në lidhje me keqpërdorimin e pozitës dominuese; Mbrojtja e konkurrencës në raport me përqendrimet e ndaluara.</p>
<i>Java e nëntë:</i>	<p>Dispozitat ndëshkuese Gjobat për shkelje të rënda; Gjobat për shkelje të lehta; Gjobat për shkeljet nga personat përgjegjës; Pagesat ndëshkuese periodike; Mënyra dhe kriteret e shqiptimit të gjobave; Lirimi nga gjoba dhe zvogëlimi i gjobës.</p>
<i>Java e dhjetë:</i>	<p>Bashkëpunimi me organet e tjera dhe mbrojtja gjyqësore Mjetet juridike kundër shkaktimit të dëmit; Bashkëpunimi i Autoritetit me Gjyqësorin dhe organet e tjera; Bashkëpunimi i Autoritetit me institucionet simotra; Mbrojtja gjyqësore;</p>

	Përmbardimi i gjobave dhe parashkrimi.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	E Drejta e Bashkimit Evropian dhe mbrojtja e konkurrencës E drejta e konkurrencës si një prej shtyllave kryesore të sistemit ekonomik të Bashkimit Evropian; Traktatet e BE-së dhe E Drejta e Konkurrencës (TFEU - Treaty on the Functioning of the European Union - Traktati mbi funksionimin e Bashkimit Evropian); Infrastruktura ligjore vendore në harmoni me atë evropiane; Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit vendor dhe atij evropian.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	E drejta e konkurrencës dhe mbrojtja e konsumatorëve Mbrojtja e konsumatorëve është fushë e ndarë por e lidhur ngushtë me të drejtën e konkurrencës; Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve; Mbrojtja e konsumatorëve nga kushtet e padrejta të kontratave; Përgjegjësia e prodhuesve, e distributorëve dhe e shitësve për mallin dhe shërbimet; E drejta e konsumatorëve për informim.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Mbrojtja nga konkurrenca jolojale - zhvillime të reja Zhvillimi i shërbimeve dhe tregtisë elektronike në ndryshimin e koncepteve klasike të mbrojtjes së konkurrencës; Raste aktuale të cilat janë në zhvillim para Komisionit Evropian për mbrojtje të konkurrencës
<i>Java e katëmbëdhjetë:</i>	Testi II
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përmbledhje e lëndës, si dhe publikimi i pikëve të arritura për secilin student/e.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Student-i/ja duhet të jetë i/e ndërgjegjsh-ëm/me dhe të respektojë institucionin, statutin dhe aktet e tjera ligjore të UP-së; duhet të respektojë orarin e ligjëratave; të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në orën mësimore; student-i/ja është i/e obliguar ta posedojë më vete ID-kartelën në ligjërata, testet dhe provimin final; gjatë hartimit të punimeve seminarike, student-i/ja duhet t’u përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student/e. Prandaj, studentët duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.</p> <p>Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet sipas akteve ligjore të UP-së.</p>	